



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:165413  
Datë: 02.02.2024  
Numri i dokumentit: 05280908  
P.nr.544/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit B.D., me vendbanim në rr....., Prishtinë, me numër personal ....., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - PP.II.nr.5738/18 të datës 19.11.2018, për veprën penale – Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me Marrëveshjen për Ndërmjetësim me shifrën ND.nr.13/24 të datës 01.02.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të të pandehurit B.D. dhe të dëmtuarës KEDS përmes përfaqësues së saj Diellza Lukaj, konform nenit 357 par.1.3 të KPPRK-së lidhur me nenin 14 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 02.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET Marrëveshja për Ndërmjetësim me shifrën ND.nr.13/24 të datës 01.02.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të të pandehurit B.D. në njëri anë dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar Diellza Lukaj – KEDS në anën tjetër.

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5738/18 e datës 19.11.2018 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit B.D., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5738/18 më datën 19.11.2018, kundër të pandehurit B.D., për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Në seancën e datës 22.12.2023, i pandehuri dhe pala e dëmtuar kanë shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për referimin e lëndës në ndërmjetësim. Gjykata ka kërkuar edhe mendimin e

Prokurorit të Shtetit Valdrin Krasniqi, e cila duke vlerësuar se plotësohen kushtet ligjore për ndërmjetësim, është pajtuar me propozimin e palëve.

Pas propozimit të palëve, duke vepruar konform nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos që lënda të dërgohet në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me datë 01.02.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Prishtinë është arritur marrëveshja ND.13/24, në mes të palës së dëmtuar dhe të pandehurit.

Gjykata vlerësoi se marrëveshja për ndërmjetësim pasqyron vullnetin e lirë të palëve dhe është e lidhur në pajtim me ligjin andaj duke vepruar në pajtim me nenin 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësim nr. 06/L-009, me datë 02.02.2024 e aprovoi këtë marrëveshje, e cila pas aprovimit nga Gjykata, përkatësisht nga data 02.02.2024 kjo marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 454 par. 1 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lartë konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së lidhur me neni 15.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
P.nr.544/19, datë 02.02.2024

Gj y q t a r i

---

Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa.